



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 29 janar 2013
Nr. ref.:RK 357/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI157/11

Parashtrues

**Bashkimi i Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës i Republikës së Kosovës,
përfaqësuar nga z. Azem Ejupi, avokat**

**Kërkesë për rregullimin e statusit të pensionistëve dhe të invalidëve të punës
dhe përmirësimin e mirëqenies së pensionistëve të Republikës së Kosovës nga
autoritetet shtetërore**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Bashkimi i Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës i Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga z. Azem Ejupi, avokat.

Objekti i çështjes

2. Çështja bazë e lëndës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata) ka të bëjë me kërkesën e Bashkimit të Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës të Republikës së Kosovës përkitazi me njohjen e të drejtës statusore dhe sociale për sigurimet pensionale dhe invalidore.
3. Parashtruesi, ndër të tjera, kërkon nga Gjykata që të ndikojë tek autoritetet shtetërore në zbatimin e Ligjit mbi Sigurimin Pensional dhe Invalidor të ish-KSA të Kosovës, sepse, sipas parashtruesit, ligji në fjalë ende nuk është shfuqizuar me asnjë akt tjetër. Me këtë ligj, pensionistët dhe invalidët e punës pohojnë se e kishin të rregulluar statusin e pensionistit dhe kanë gëzuar të drejtat që ua mundësonte ky ligj.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), dhe rregulli 28 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 2 dhjetor 2011, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
6. Më 30 nëntor 2012, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës me Nr. KI157/11.
7. Më 5 janar 2012, Kryetari, me vendimin GJR. KI157/11, caktoi gjyqtaren Iliriana Islami Gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me vendimin KSH. KI157/11, caktoi Kolegjin shqyrtues, në përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy (anëtar) dhe Gjyljeta Mushkolaj (anëtare).
8. Më 26 nëntor 2012, Kryetari, me vendimin GHR. 157/11, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu Gjyqtar raportues, që e zëvendëson gjyqtaren Iliriana Islami, e cila, më 26 qershor 2012, përfundoi mandatin e saj si gjyqtare në Gjykatë dhe caktoi anëtarët e Kolegjit të ri shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy (anëtar) dhe Arta Rama-Harizi (anëtare), që e zëvendëson gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj, e cila po ashtu, më 26 qershor 2012 përfundoi mandatin e saj si gjyqtare në Gjykatë.
9. Më 17 janar 2013, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Parashtruesi rrëfen se, prej vitit 1998 dhe deri më sot, pensionistët e Kosovës nuk kanë pranuar pensionin e merituar dhe janë ende pa sigurime shëndetësore dhe sociale, pa status të zgjidhur dhe në gjendje jo të përshtatshme materiale. Parashtruesi pohon se më të shkelurit janë pensionistët që kanë paguar kontribute për sigurimin pensional dhe invalidor, duke përfshirë edhe pensionistët familjarë.
11. Parashtruesi pretendon se pensionistët janë diskriminuar fillimisht nga pushteti i Serbisë, ndërsa, pas vitit 1999, nga UNMIK-u dhe, së fundmi, edhe nga autoritetet qeveritare të Republikës së Kosovës. Parashtruesi, ndër të tjera, pohon:

“Prej fundit të vitit 1998, deri në gusht të vitit 2002, pensionistëve nuk u është paguar kurrfarë shume e pensionit. Tek pas miratimit të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/35, dt. 21 dhjetor 2001, mbi Pensionet në Kosovë, e ndryshuar me Rregulloren Nr. 2005/20, si dhe Ligjit Nr. 2002/11 mbi Metodologjinë e caktimit të lartësisë së pensionit bazë në Kosovë dhe caktimin e datës për sigurimin e pensioneve bazë, prej 1 korrikut 2002 ka filluar njëfarë pagese e quajtur pensioni bazë, nga 28 marka gjermane në muaj, për të gjithë personat me moshe mbi 65 vjeç”.

12. Parashtruesi përmend faktin që, shumë nga pensionistët kontributpagues, të drejtën e pensionit e kanë fituar në bazë të Ligjit mbi Sigurimin Pensional dhe Invalidor të ish-KSA të Kosovës (Gazeta Zyrtare e KSAK, Nr. 26/83, Nr. 26/86 dhe Nr. 11/88). Sipas parashtruesit, ligji në fjalë nuk është shfuqizuar ende me asnjë akt dhe, sipas dispozitave të atij ligji, pensionisti, në bazë të statusit të fituar ligjor, kishte të drejtë jo vetëm për pagesën e pensionit të llogaritur në bazë të stazhit të punës dhe shumës së kontributeve të paguara, por kishte edhe një varg privilegjesh dhe të drejtash të tjera.
13. Parashtruesi pohon se sot pensionistët nuk gëzojnë asnjë nga të drejtat që kishin fituar në bazë të ligjit në kohën kur kanë dalë në pension. Ata vetëm e marrin një shumë të caktuar 45+35 euro, gjithsej 80 euro, dhe asgjë me tepër, pa marrë parasysh gjatësinë e stazhit ose shumën e kontributeve të paguara.

Pretendimet e parashtruesit

14. Parashtruesi i kërkesës pretendon se, duke mohuar dhe duke hequr të drejtat e fituara në bazë të Ligjit mbi Sigurimin Pensional dhe Invalidor, pensionistëve kontributpagues u janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 22, me nenin 23, me nenin 51 (paragrafi 1) të Kushtetutës, me nenin 17 (paragrafi 2) të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, me nenin 26 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe me protokollet e tij, dhe me nenin 9 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

15. Gjykata, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, duhet që, së pari, të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje me Ligj dhe me Rregullore të punës.
16. Parashtruesi i kërkesës duket të jetë i pakënaqur me autoritetet qeveritare, të cilat janë të thirrura t'i parashohin dhe t'i rregullojnë çështjet që kanë të bëjnë me politikën sociale, përkatësisht të bëjnë rregullimin e statusit të pensionistëve dhe të invalidëve të punës.
17. Gjykata ka vërejtur se parashtruesi i kërkesës nuk ka specifikuar ndonjë akt të autoritetit publik (*Shih, neni 48 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese*), me të cilin pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe me konventa ndërkombëtare që aplikohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës. Por, vetëm ka ngritur çështjet që kanë të bëjnë me rregullimin e politikave sociale, përkatësisht me përmirësimin e mirëqenies së pensionistëve dhe të invalidëve të punës, duke kërkuar nga Gjykata të sqarojë se përse nuk janë marrë parasysh nga autoritetet shtetërore kërkesat e parashtruesit për sa i përket të drejtave të pensionistëve dhe të invalidëve të punës.
18. Gjykata i referohet nenit 113, paragrafit 1, të Kushtetutës, që parasheh:

Neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.

19. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës ka kërkuar që Gjykata t’u bëjë thirrje autoriteteve qeveritare, përkatësisht ministrive përkatëse, që të hartojnë Ligjin për Pensionistët dhe Invalidët e Punës, si dhe të nxjerrin Ligjin për Sigurimin Shëndetësor.
20. Përkitazi me këtë, Gjykata i referohet nenit 4 të Kushtetutës, që përcakton në mënyrë të qartë formën e qeverisjes dhe ndarjen e pushteteve:

Neni 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit]

“[...]”

2. Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ

“[...]”

4. Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar”.

21. Neni 65 i Kushtetutës ka përcaktuar qartë kompetencat e Kuvendit të Republikës së Kosovës:

Neni 65 [Kompetencat e Kuvendit]

“[...]”

(1) miraton ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme”.

22. Po ashtu, neni 93 i Kushtetutës përcakton qartë kompetencat e Qeverisë:

Neni 93 [Kompetencat e Qeverisë]

“Qeveria ka këto kompetenca:

(1) propozon dhe zbaton politikën e brendshme dhe të jashtme të vendit;

“[...]”

(3) propozon Kuvendit projektligje dhe akte të tjera;

(4) merr vendime dhe nxjerr akte juridike ose rregullore, të nevojshme për zbatimin e ligjeve”.

23. Megjithatë, neni 113 i Kushtetutës, në mënyrë të qartë ka paraparë se kush mund të konsiderohet palë e autorizuar për të referuar çështje kushtetuese përkitazi me vlerësimin e kushtetutshmërisë së një akti të një autoriteti publik dhe përkitazi me vlerësimin e kushtetutshmërisë së një ligji.
24. Faktikisht, parashtruesi i kërkesës, në rastin konkret, vepron si person juridik dhe i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, si bazë juridike për parashtrimin e kërkesës së tij.
25. Gjykata ka analizuar dhe ka vlerësuar me kujdes kërkesat e parashtruesit dhe konkludoi se parashtruesi i kërkesës, si person juridik në rastin konkret, nuk mund të konsiderohet palë e autorizuar që të mund të referojë çështje kushtetuese *in abstracto* përkitazi me rregullimin e statusit të pensionistëve dhe të invalidëve të punës, si dhe përkitazi me përmirësimin e mirëqenies sociale të tyre, duke u bazuar në kontributet pensionale të paguara gjatë viteve.
26. Përveç kësaj, Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk parasheh *actio popularis*, që është modalitet i ankesave individuale, çfarë i mundëson çdo individ, që tenton të mbrojë interesin publik dhe rendin kushtetues, t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me pyetje dhe me kërkesa të caktuara, duke aluduar për shkelje të të drejtave kushtetuese të një individi a të një grupi të caktuar.

27. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk është palë e autorizuar për të referuar çështje kushtetuese *in abstrakto* përkitazi me rregullimin e statusit të pensionistëve dhe të invalidëve të punës. Për këtë arsye, në pajtim me nenin 113.1 të Kushtetutës, kjo kërkesë konsiderohet e papranueshme.
28. Rrjedhimisht, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 20 të Ligjit, dhe në pajtim me rregullin 56.2 të Rregullores së punës, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 të Kushtetutës dhe në pajtim me rregullin 56.2 të Rregullores së punës, më 17 janar 2013, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe,
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Kadri Kryeziu

Prof. dr. Enver Hasani

